

**STEREOTIPET GJINORE PËRMES BARRIERAVE KULTURORE
(VARIABLET IDENTITET GJUHËSOR-DALLIM GJINOR)**

**GENDER STEREOTYPES ACROSS CULTURAL BARRIERS
(LINGUISTIC IDENTITY-GENDER DIFFERENCE VARIABLES)**

Merita HYSA¹, Rrezarta DRAÇINI²

1 Department of Linguistic, Faculty of Social Sciences, University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"*

2 Department of Linguistic, Faculty of Social Sciences, University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"*

** Corresponding author email: merita.hysa@unishk.edu.al rrezarta.dracini@unishk.edu.al*

Abstract

At the basis of language as a social phenomenon is variability, not only in space and time, as is usually treated in linguistic studies, but rather in use, what makes a language system work. The concept of sociolinguistic variables affects not only the system but especially children, how this corpus happens to us during different performance acts, and how language is realized in a language system. The relative distribution in languages of various variables gives us important information on social structure and language/society relations, narrowing the thought of language interaction.

Within the framework of discourse paradigms, we will not dwell on one of its aspects, sociolinguistic in the binomial social identity/gender identity. that of social stratification is not new in our linguistic studies. How gender interacts with several other crimes raises the concept of sociolinguistic variables and is related not only to the individual aspect but also to the performative manifestations of the discourse community. and feminine, related to these characteristics of relationships, roles, expectations, and different opportunities within the social community.

Keywords: linguistic identity, cultural identity, variable, gender.

Përmbledhje

Në bazë të gjuhës si dukuri shoqërore është ndryshueshmëria, jo vetëm në hapësirë dhe në kohë, siç rëndom trajtohet në studimet gjuhësore, por më tepër në pikëpamje të përdorimit, ajo çka e bën një sistem gjuhësor të funksionojë realisht. Koncepti i variabileve sociolinguistike prek jo vetëm gjuhën si sistem, por sidomos mënyrën sesi ky korpus na shfaqet gjatë akteve të ndryshme performative, si dhe mënyrave të ndryshme përmes të cilave realizohet një sistem gjuhësor. Përndarja relative në një gjuhë e tipeve të ndryshme të variabileve, na jep informacione të rëndësishme mbi strukturën sociale dhe raportet gjuhë/shoqëri, duke ngërthyer në vetvete modelet themelore të ndërveprimit gjuhësor.


Brenda skemave të paradigmave ligjërimore, ne do të ndalemi në një prej aspekteve të shqyrtimit sociolinguistik, në binomin identitet social/identitet gjinor. Shqyrtimi i marrëdhënieve mes gjinisë dhe tipareve të folurit, si një raport simbiotik, si në pikëpamje gjuhësore, ashtu edhe në atë të shtresëzimit social, nuk është i ri në studimet tona gjuhësore. Mënyra se si gjinia ndërvepron me një sërë faktorësh të tjerë, cek konceptin e variabileve sociolinguistike dhe lidhet jo vetëm me aspektin individual, por edhe me shfaqjet performative të bashkësisë ligjërimore. Koncepti i gjinisë na shpie te ndërtimi historik i përfaqësimeve sociale dhe i identiteteve mashkullore e femërore, të lidhura këto me modelet e lidhjeve, roleve, pritshmërive e mundësive të ndryshme brenda bashkësisë shoqërore.

Fjalët kyçe: identitet gjuhësor, identitet kulturor, variabile, stereotipe gjinore, konstrukte ligjërimore.

Hyrje

Në bazë të gjuhës si dukuri shoqërore është ndryshueshmëria, jo vetëm në hapësirë dhe në kohë, siç rëndom trajtohet në studimet gjuhësore, por më tepër në pikëpamje të përdorimit, ajo çka e bën një sistem gjuhësor të funksionojë realisht. Prania e variabileve në gjuhë, ka dominuar studimet sociolinguistike, sidomos në gjysmën e dytë të shek.XX. Identifikimi i paradigmeve ligjërimore në diferencimin e sjelljeve gjuhësore, mund të shihet si pjesë e ndërveprimit shoqëror, qoftë në komunikimin mes individëve, pjesë e grupeve të përziera, qoftë edhe në peer-grupe të së njëjtës gjini. Të kundruarit e gjuhës si një mënyrë të vepruari, shpesh na çon në konturimin e elementeve që përbëjnë domenet e ndërveprimit sociolinguistik.

Përcaktimi i variabileve gjuhësore brenda organizmave mikro- dhe makrosociolinguistike të sistemeve shoqërore, na orienton në dy modelet paradigmatiche të ndërveprimit sociogjuhësor: paradigma deskriptive (Tollefson,1981) dhe paradigma vlerësuese (Rubin and Jernudd, 1971). Modeli i paradigmes përshkruese shfaq tipin e marrëdhënieve mes strukturave gjuhësore dhe organizimit social të sjelljeve, duke identifikuar dhe përqsaur variabilet sociolinguistike, ndërkohë që paradigma vlerësuese e orienton vëzhgimin te mekanizmat që bëjnë të mundur ndryshimin e qëllimshëm të këtyre marrëdhënieve dhe shqyrton aktivitetin e planifikimit përshkrues.



Koncepti i variabileve sociolinguistike prek jo vetëm gjuhën si sistem, por sidomos mënyrën sesi ky korpus na shfaqet gjatë akteve të ndryshme performative, si dhe mënyrave të ndryshme përmes të cilave realizohet një sistem gjuhësor.

Përqsasja e përgjithshme metodologjike

Në këtë studim jemi përqëndruar në vëzhgimet e drejtpërdrejta të ligjërimeve publike, anketimeve si dhe hulumtimit teorik të teksteve. Kemi synuar të përdorim si metodën eksperimentale, ashtu edhe atë natyrore, me qëllim që të krijohet një panoramë sa më e plotë e ideve të parashtruara në punim. Gjatë hulumtimit, e kemi parë të arsyeshme të kombinojmë elementet e ndryshme të secilës metodë, kjo me synimin që të bëhej një mbledhje sa e plotë e të dhënave, përmes vëzhgimit teorik, analizës së situatave gjuhësore, anketimit të disa subjekteve folëse dhe në fund deduktimit përmes shqyrtimit të të gjitha të dhënave të mbledhura.

Hulumtimi

Brenda skemave të paradigmeve ligjërimore, ne do të ndalemi në një prej aspekteve të shqyrtimit sociolinguistik, në binomin identitet social/identitet gjinor. Koncepti i gjinisë na shpie te ndërtimi historik i përfaqësimeve sociale dhe i identiteteve mashkullore e femërore, të

lidhura këto me modelet e lidhjeve, roleve, pritshmërive e mundësive të ndryshme brenda bashkësisë shoqërore. Diferencat gjinore kanë të bëjnë me pozicionet relative që u caktohen meshkujve dhe femrave në organizimin e jetës dhe të punëve.

Gjinia si konstrukt është një koncept gjenerik, që mund ta shohim në të gjitha shfaqjet polisemike të tij. Në një perspektivë sociologjike, identiteti shoqëror dallohet dukshëm nga ai personal (përfshirë këtu edhe atë gjuhësor). Tërësinë e tipareve identitare që karakterizojnë një individ, mund ta shohim si në pikëpamje të ngushtë, si formë e identitetit personal, ashtu edhe si element dallues i një socio-grupi të caktuar. Simbioza e pazgjidhshme sociolekt-idiolekt, mund të shfaqet qartazi e konturuar në dy pyetje në dukje të thjeshta:

-*Çfarë je?*

-*Kush je?*

Në këtë mënyrë ne abstragojmë nga tërësia e tipareve që e bëjnë një individ të ngjashëm me të tjerët (përbashkësitë me grupin), në elementet e veçanta që konturojnë profilin e tij si në pikëpamje sociale, ashtu edhe në pikëpamje gjuhësore. Tiparet gjinore, përbëjnë një prej elementeve të përfaqësimeve identitare brenda grupeve shoqërore. Nga vetë mënyra e konceptimit, stereotipet gjinore kanë një karakter të dyfishtë: përcaktojnë atë që janë personat, por edhe si duhet të jenë; krijojnë pritshmëri të ndryshme për sjelljet mashkullore dhe femërore, duke përfunduar me një formë të funksionit normativ në konfigurimin e një tipi të caktuar sjellje, më të dëshiruar për një gjini sesa për tjetrën.


Sa i takon gjuhës, diskriminimi seksist është i dyfishtë dhe shfaqet si në përdorimin e gjuhës (ashtu siç flitet nga gratë), ashtu edhe në sistemin e përgjithshëm të gjuhës (atë që sistemi gjuhësor vë në dispozicion për t'iu referuar grave). Shpesh duket sikur gjuha që flasim dhe praktikatat seksite që ajo inkorporon janë indikatorë, në mos edhe përgjegjës të stereotipave gjinorë të pranishëm në shoqëri. Këto diferenca gjuhësore mes femrave dhe meshkujve vërehen si në nivel strukturor, pra të normave gjuhësore të kodifikuara në gramatikë, ashtu edhe në nivel semantik, dmth. në kuptimin dhe përdorimin e njësisive leksikore dhe të imazheve.

Duke u nisur nga një konceptim që e sheh gjuhën jo vetëm si një mjet komunikimi, por mbi të gjitha si një mjet perceptimi e klasifikimi të realitetit, duket e rëndësishme që përdorimi i saj të jetë “korrekt”, jo në kuptimin normativ-perceptiv të termit, por, në atë të barazisë, të së drejtës, jo diskriminues karshi asnjë grupi social. Përdorimi i gjuhës si mjet pushteti është një qëndrim i njohur në përvojën njerëzore. Mënyra se si shfaqet dominimi gjinor, qoftë në strukturën gjuhësore, qoftë edhe në shtresëzimin social, na shfaq një realitet të pamohueshëm tanimë.

Lidhja mes gjuhës dhe seksizmit gjuhësor mund të përshkruhet në dy drejtime: seksizmi brendagjuhësor, dmth. çfarë vë në dispozicion sistemi gjuhësor për t'ju referuar femrave dhe seksizmi në përdorimin e gjuhës, dmth. si flitet për femrat. Seksizmi gjuhësor (Robustelli, 2000) merr në konsideratë imazhin e grave që buron nga praktika gjuhësore dhe nga kontrasti gjithmonë e më i dukshëm mes ngritjes sociale të femrave dhe ngurtësinë e një gjuhe të ndërtuar/dhe për meshkujt. Për të parë me vëmendje ndikimin e stereotipit gjinor në strukturën e gjuhës, një pikënisje e mirë do të ishte të përshkruanim normat që e rregullojnë atë, si në sistemin e formimit të fjalëve, (aspekti lokutor i ndërtimit të mesazheve gjuhësore), ashtu edhe në nivel pragmatik, në përzgjedhjen e mekanizmave themelorë që mundësojnë përzgjedhjen e formave të sakta dhe qasjes ekstralinguistike që ka përdorimi i gjuhës në kontekste të ndryshme (aspekti perllokutor).


Gjuhëtarët tradicionalisht e kanë dalluar “gjininë gramatikore” (pra klasifikimin e emrave në bazë të morfologjisë gjuhësore), nga gjinia natyrore, ose biologjike (ndarja e qenieve njerëzore në kategori binare që bazohen në morfologjinë anatomike). Kjo e fundit është vënë në dyshim nga një sërë studimesh të zhvilluara në kuadrin e teorisë së gjinisë (brenda antropologjisë së gjuhës), të cilat tregojnë që gjinia është një konstrukt social më tepër se një e dhënë biologjike dhe se “natyrshmëria” e saj duhet të përgjithësohet në nivel bisedor.

Në këtë mënyrë, përpjekjet për të lexuar strukturën gjuhësore nuk gjenden në analizën abstrakte të sistemit gjuhësor, por në mënyrën se si vihet në përdorim ky sistem. Për këtë arsye shpesh shohim të përdoret sintagma “gjinia sociale”, pasi gjinia nuk është vetëm një kategori gramatikore që rregullon përshtatshmërinë në nivel paradigmatic, përkundrazi është një kategori semantike që shfaq brenda një gjuhe një simbolizëm të thellë. (Violi, 1986)



Modelet paradigmatiche në shqipe, na ofrojnë struktura emërore komplekse (morfema leksikore (rrënja) + morfema gramatikore (ndajshitesa), të cilat në nivele të ndryshme fjalëformuese modifikojnë strukturën semantike të fjalëve. Pra te fjala, krahas bazës leksikore “semantemës” që është një formë e lirë, ekziston edhe një element gramatikor i lidhur, i cili gjeneron struktura semantike të reja të cilat i nënshtrohen ndryshimit të vazhdueshëm nga realiteti jashtëgjuhësor. (Dardano, 2008).

Sistemet gjuhësore që kanë një paradigme gjinore të formësuar qartë (ku përfshihet edhe shqipja), duket se bazohen mbi një parim androcentik, dmth, format përfaqësuese gjuhësore janë pa diskutim të gjinisë mashkullore, duke krijuar kështu një stereotip gjuhësor përfaqësues. Asimetritë gjuhësore që krijohen në këtë variabile mund t’i kundrojmë në dy plane: asimetri gramatikore dhe asimetri semantike.



Në shumicën e rasteve, në shqipe, forma bazë është ajo e gjinisë mashkullore, e indikuar si forma parësore e fjalëve në fjalor, nga ku shpesh formohen emrat e gjinisë femërore. Kalimi nga forma mashkullore tek ajo femërore nuk është gjithmonë i njëjtë, tipat e ndërtimit ndryshojnë. Mashkullorja konsiderohet si gjini jo e markuar, forma bazë, nga e cila rrjedhin modele të reja fjalëformuese përmes ndajshitesimit. Përdorimi përfaqësues (i pamarkuar) i gjinisë mashkullore që nënkupton edhe gjininë femërore, në aspektin gramatikor krijon një stereotip të njëanshëm në konstruktet sociale, duke i lënë hapësira diskriminimeve me bazë gjuhësore.

Ekzistenca e formave përfaqësuese “neutrale” të gjinisë mashkullore, si pjesë e komunikimit masiv, përbën një tjetër aspekt mirëfilli gramatikor të paradigmave ligjërimore në këtë variabile sociolinguistike. Kështu në shqipe, rregullat e përshtatjes sintaksore të plotësve janë të orientuar thuajse tërësisht nga gjinia mashkullore, mjafton që në një sintagmë të ketë një emër mashkullor, pa diskutim edhe mbiemrat apo fjalët e tjera përcaktuese do të kenë të njëjtën gjini. Në qoftëse do të shkëpusnim pjesë të ligjërimeve publike, qoftë në mediane e shkruar, të folur apo në publicistikë, do të vërejmë një përdorim të madh të përfaqësimeve mashkullore në komunikimet formale.

Përparësia e mashkullores në binomin mashkullor/femëror të tipit:
djem dhe vajza,
zonja dhe zotërinj,

shokë dhe shoqe etj, tregon sa i ndjeshëm është ky përcaktim gjinor nga lokutorët.

Më tej, shohim rëndom të përdoren format e përgjithësuara të kësaj mashkulloreje “neutrale” që përdoret natyrshëm në përcaktime semantike dygjinore të tipit: *-studentët, punëtorët, zgjedhësit, votuesit, deputetët, mësuesit, profesorët, emigrantët, qytetarët, të afërmit* etj. Shumë rrallë ndeshim përdorimin e formave gjegjëse femërore, qoftë edhe të markuara në një lloj mënyre. Në këtë përmasë semantiko-morfologjike, variabiliteti sociolinguistik na shfaqet i orientuar më tepër drejt një baze androgjene, si formë e përdorimit të përgjithshëm gjuhësor. P.sh. format apelative të ligjërimit publik si:

Të dashur studentë, Të nderuar kolegë, deputetë etj.

Por, nuk duhet të harrojmë që gjinia mashkullore nuk është përfaqësuese absolute, studentët janë edhe studente, punëtorët edhe punëtore, zgjedhësit edhe zgjedhëse e kështu me radhë. Gjithashtu, në komunikimin zyrtar një vend të veçantë zë edhe përdorimi i formave përfaqësuese mashkullore, kur shënohen profesionet. Kështu, lexojmë “*Psikologu gjyqësor i çështjes është doktoresha D.S, ose mjeku ligjor, doktoresha A.B, pedagogu i lëndës* etj. Identifikimi i figurës së femrës përmes modelit mashkullor që e shoqëron është një tjetër tipar i orientimit androgjen të akteve perlokutore, si psh. *gruaja e kryeministrit, vajza e..., e veja e ...* etj, shpeshherë edhe pa u ndalur në identitetin e tyre. Ose në prezantimet shoqërore: *Presidenti i Republikës ... dhe zonja e tij*, ose si modeli më bashkëkohor që serviret në media, “*zonja e parë*”, *kryetari i bashkisë E.T. dhe zonja...*, e mjaft modele të këtij lloji që i ndeshim çdo ditë.

Një tjetër tipar gramatikor që motivon një aspekt të varibles sociolinguistike në dallimet gjinore është edhe prania e dy prapashtesave tipike që gjenerojnë emra të gjinisë femërore nga tema të gjinisë mashkullore, *-e* dhe *-eshë*. *-Prapashtesa -e*, formon emra të gjinisë femërore, kryesisht emra të vepruesit (edhe ky përcaktim me tipare androgjene) dhe emra të profesioneve që kanë domosdo kundërvënien mashkullor/femëror. (E.Hysa, 2004) Krijimi i modeleve aktive fjalëformuese në këtë aspekt, çon në përdorimin e njësuar të formave gjuhësore në shqipe si psikologe, ministre, arkitekthe etj.

Prapashtesa *-eshë*, bashkohet rregullisht me tema të emrave të gjinisë mashkullore të numrit njëjës. Shërben për të formuar një klasë të gjerë emrash, që shënojnë zakonisht gruan a femrën e mashkullit. (E.Hysa, 2004). Mendojmë se një përcaktim i tillë ka një konotacion negativ, sidomos kur krahas përdorimit të natyrshëm, në forma si *princeshë, baroneshë, përëndeshë, doktoreshë*, vërejmë formime të markuara negativisht, në trajta të tipit *profesore* përkundrjet *profesoreshë, ministreshë* përkundrjet *ministre, studenteshë*, përkundrjet *studente, dasmoreshë/dasmore* etj.,

Forma të tilla jepen si elemente denigruese ndaj funksionit të femrës, apo markimit social që i bëhet përfshirjes së saj në sferën sociale. Ndoshta pasiguritë gramatikore mbi këtë çështje varen nga arsye jashtëgjuhësore. Shkaqet janë të tjera, të motivuara jo nga fakte gjuhësore, por më tepër nga arsye të tipit sociolinguistik, të orientuara nga ndryshimet e shpejta të statusit social të femrave dhe integritetit të tyre në profesione e role institucionale që më parë u rezervoheshin meshkujve.

Përdorimi i gjinisë në perspektivën sociolinguistike

Variabilet që përcaktojnë dallimet gjinore, brenda konturit social të gjuhës, na lejuan të vërejmë tiparet e përgjithshme të ligjërimit të femrave, si dhe çka e markon një sistem gjuhësor në pikëpamje të stereotipave që krijohen nga përdorimi i formave gjuhësore. Kur flitet për seksizëm gjuhësor, më saktë për paragjykimet e stereotipeve gjuhësore që markojnë gjininë femërore, zakonisht sjellim ndër mend shembuj nga shtypi, ose nga mjetet e komunikimit


masiv. Por duhet të kundrojmë edhe aktet e komunikimit që prodhojmë çdo ditë dhe natyrën e mesazheve përmes të cilave tejqojmë mendimet tona. Në këtë mënyrë, koncepti i variabileve mund të shihet më gjerë, i konkretizuar në të gjitha nivelet gjuhësore që përbëjnë një variant të caktuar, në rastin tonë, një sociolekt.

Në studimet gjuhësore dhe sociologjike të gjysmës së dytë të shekullit të XX²⁵⁷, është theksuar më tepër lidhja e tipareve gjinore me përdorimet gjuhësore. Në këto studime vihet re se nuk mund të flasim mirëfilli për dallime në përdorimin e formave gjuhësore, por mund të ndryshojnë frekuencat e përdorimit të tyre dhe qasjet e ndryshme ndaj varieteteve gjuhësore dhe modelimit të të folurit. Sipas Trudgill (2001) diferencimi gjinor në gjuhë lind sepse gjuha si dukuri shoqërore është e lidhur ngushtë me qëndrimet sociale. Identiteti gjinor sipas tij, sikurse llojet e tjera të tij (etnik, fetar, social) bën që individët të përzgjedhin format gjuhësore në përkim me situatat e komunikimit dhe bashkëbiseduesit.

Ky variacion stilistik, pjesë e variacionit shoqëror, bën që krahas variabileve moshë, klasë sociale, grup etnik, të shihen edhe skemat ligjërimore edhe përbërësit gjinorë. Në këtë kuadër teorik, në pikëpamje të strukturimit të mendimit dhe organizmit gjuhësor, ne kemi hartuar një sondazh, në të cilin kemi përfshirë rreth 60 subjekte (40 femra dhe 20 meshkuj), me qëllim identifikimin e tipareve të veçanta të ligjërimit femëror, por jo vetëm. Të dhënat e anketës kanë nxjerrë në pah një sërë tiparesh, interpretimi i të cilave ka hedhur dritë mbi disa çështje të karakterit sociolinguistik. Ne kemi paraqitur grafikisht vetëm disa prej pyetjeve, ndërkohë që pyetjet e tjera i kemi parashtruar si interpretim të dhënash.

Së pari, anketa jonë lidhej me grupmoshën dhe orientimin social (student/studente dhe profesionist/profesioniste).

1. Grupmosha së cilës i përkisni
60 risposte



Dominante në sondazh, ka qenë grupmosha e re 18-22 vjeç.

Së dyti, Pyetjes nëse vërehen forma të ndryshme në përdorimin e gjuhës nga meshkujt, përkundëjt femrave, pjesa më e madhe e të anketuarve/anketuarave (61.70%) iu janë përgjigjur *shpeshherë dhe* 28.30%, *sipas situatave të komunikimit*. Një fakt i tillë pohon qartazi variacionin stilistik të skemave ligjërimore.

²⁵⁷ Lakoff, R. 1973. "Language and woman's place". Language in Society 2(1), pp. 45–80.


Lazar, M. (ed.) (2005) *Feminist critical discourse analysis: gender, power and ideology in discourse*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.

Manne, K. (2018) *Down girl: the logic of misogyny*. Oxford University Press.

Mills, S. (2008) *Language and sexism*. Cambridge University Press.


Pauwels, A. (1998) *Women changing language*. London: Longman.

2. A përdorin forma të ndryshme gjuhësore meshkujt përkundrejt femrave?
60 risposte




Orientimi në përdorimin e formave gjuhësore, ka nxjerrë në pah një tipar që e theksuam më sipër, i cili lidhet me praninë e formave përfaqësuese mashkullore në gjuhë, si dhe me dominancën e formave gjuhësore mashkullore në ligjërimet publike. Të dhënat shfaqin këtë tipar në 35% të të anketuarve/anketuarave; 30% shfaq prirjen konformiste të përshtatjes me modelet e komunikimit të grupit shoqëror; 25% prek tipet e ndryshme të situatave të komunikimit.

3. Shënoni cili prej faktorëve është më tipik në diferencimin e ligjërimin të femrave përkundrejt atij të meshkujve
60 risposte



Larmia e formave të komunikimit në ditët e sotme, karakterizohet nga një spektër i gjerë i akteve ligjërimore. Cilësimet në përzgjedhjen e gjinisë përfaqësuese në format e komunikimit publik janë pasyqyruar edhe në sondazhin tonë, subjektet e të cilit në masën 53.3% mendojnë se mund të shmanget, duke i përdorur të dyja format gjinore.


4. Përdorimi i formave përgjithësuese mashkullore në ligjërimet publike është:
60 risposte



Prirjet në përdorimin gjuhësor, krijimi i stereotipave dialektorë që lidhen me orientimin drejt standardit janë disa çështje të tjera që trajtuam në sondazhin tonë. Orientimi më i natyrshëm i femrave drejt trajtave normative në situata formale, është një e dhënë tjetër që të anketuarit/anketuarat i dhanë përgjigje. Situata e komunikimit është një përbërës dominant i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në variacionet stilistike.


5. A vini re shpesh dallime në komunikimin mes femrave dhe meshkujve?

60 risposte




6. A ka ndryshime në përzgjedhjen e fjalëve gjatë komunikimit vetëm mes femrave?

60 risposte



7. A ka ndryshime në përzgjedhjen e fjalëve gjatë komunikimit kur grupet janë të përziera? (femra-meshkuj)

60 risposte



Shqyrtimi i sondazhit në pyetjet që paraqitëm më sipër, por edhe pjesën tjetër, që vetëm e kemi analizuar, na ka ofruar një korpus interesant të dhënash, që lidhen me veçori të ligjërimit të moshës së re, rregullsitë dhe parregullsitë që vërehen në përdorimin e gjuhës, praninë e formave të zgjedhura gjuhësore, përkundrejt formave të çlirëta etj. Në pikëpamje të organizimit sintaksor, mund të veçojmë përdorimin e lidhjeve parataktike, përkundrejt atyre hipotaktike. Përdorimi i frazave të zgjatura me gjymtyrë bashkërenditëse, është një tipar interesant në ligjërimin e femrave, sidomos kur priren të përshkruajnë, ose edhe në ligjërimin normal.

Po kështu, një tipar tjetër është edhe përdorimi i shpeshtë i frazave eliptike në komunikimin e drejtëpërdrejtë dhe i strukturave holofrastike, si pjesë e ligjërimit emotiv. Mund të mendojmë se ndoshta prania e këtyre strukturave sintaksore mund të jetë frut i një prodhimi gjuhësor të vetëdijshëm, duke i dhënë interlokutorit/interlokutorëve hapësirat e nevojshme për të ndërhyrë në frazë, në qasje me variabilet e ndryshme të kontekstit të komunikimit. Ndërkohë që planifikimi i skemave të bisedës është një e dhënë e përgjithshme që karakterizon ligjërimin e femrave, zgjedhjet leksikore shërbejnë për të nënvizuar stereotipet që i bëjnë të identifikueshëm modelet e komunikimit.

Përmasa leksikore në konstruktet e bisedës, realizohet përmes përzgjedhjes së mjeteve gjuhësore, duke filluar nga përdorimi i larmishëm i emrave e mbiemrave, dyfishimit tërësor ose të pjesshëm të sintagmave emërore ose foljore, si dhe zbulimit përmes thirrësve. Stereotipi i “nënës/mamasë” është pa dyshim më i përhapuri. Diskursi mëmësor përdoret në mënyrë të vetëdijshme ose jo, nga të gjitha modelet femërore.

Tiparet që e karakterizojnë ligjërimin e grave në këtë kontekst, lidhen më përdorimin e epiteteve, fjalëve zbuuese, modifikimit të strukturës së fjalës në ndikimin e *baby talk*, i cili shtrihet edhe në komunikimin mes të rriturve, duke fituar një konotacion të ri, prania e prapashitesave zbuuese -ak, -uk, *shpirtak/shpirtuk*, *zemrak* etj. Prania e epiteteve mbiemërore, disa thujse tipike të ligjërimin femëror, si *i lezetshëm/e*, *mahnitës/e*, *fantastik/e*, tonit zbuues, dyfishimit të pjesëve të ndryshme të ligjëratës me efekt semantik përforcues, ose edhe zgjatja kompensatore e zanoreve me efekt kumbimi, janë disa tipare të përgjithshme që karakterizojnë këtë ligjërim, psh.: *shiko shiko shiko çfarë gabimiiii*, *je i vogli i vogli*, *i vogliiii i mamittt* etj. Shprehjet me tipare zbuuese të pranishme kryesisht në ligjërimin femëror, por jo vetëm, i ofrojnë ligjërimin femëror një ngarkesë emfatike, duke intensifikuar veçoritë shprehëse të tij.

A mund të kenë fjalët tipare diskriminuuese?

Do ta orientojmë vëzhgimin tonë në një përmasë tjetër. Entitetet e ndryshimeve gjinore mbështeten shpesh në përdorimin e burimeve semiotike të koduara sipas gjinisë. Në dekadat e fundit, me shtimin e numrit të botimeve letrare, por jo vetëm, kemi vërejtur një prirje, disi më e hershme në kulturën perëndimore, por që nuk ndeshet shumë në Shqipëri. Ajo ka të bëjë me diferencimin gjinor të letërsisë për fëmijë, në botime për djem dhe për vajza, siç i kemi listuar më poshtë me shembuj. Ky entitet i ndryshimit gjinor, mbështetet shumë në përdorimin e kodeve semiotike të markuara sipas përkatësisë gjinore (psh., nga tekstet e hulumtuara në vërejtëm imazhet, ngjyrat, përmbajtjen e lëndës dhe leksikun e përdorur), për ta bërë të qartë se kujt i drejtohet drejtpërdrejt produkti.

Krijimi i dikotomive të ndryshme që lidheshin me spektrin e ngjyrave (rozë-blu), me tipologjinë e personazheve (zana, magjistare, princër, përkundrejt superheronjve, kafshëve mitologjike etj.) Fëmijët e kohëve moderne mësojnë për botën jo vetëm nga ndërveprimet me njerëzit rreth tyre (rrethin familjar, peer-group, aktivizimin e tyre në arsimin parashkollor dhe në shkollë), por edhe nga produkte të konsumit e jetës së përditshme, të tilla si lodrat, veshjet, librat, filmat etj., të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë të dizenuara ose për vajzat, ose për djemtë.

Në këtë mënyrë krijohet një kuadër stereotipik i asaj që kultura jonë e konsideron “për vajza” dhe “për djem”. Në këtë prizëm, këto cilësime, mund të konsiderohen si projeksione të panevojshme dhe artificiale të kuptimeve gjinore. Fjalët në fjalor, nuk janë projektuar për të shënuar vetëm gjininë (duke veçuar këtu kategorinë gramatikore të gjinisë, apo gjininë natyrore që cilësuam më sipër).

Fjalë të ndryshme, botë të ndryshme?


Përvetësimi i leksikut është një proces që vijon gjatë gjithë jetës, si në qasjen e zhvillimit social, ashtu edhe në atë të zhvillimit psikik. Nuk duhet të jetë një perceptim normal krijimi i fushave leksikore që kanë në bazë një identitet gjinor të mbivendosur. Lemat që përcaktojnë identitetin “vajzë” apo “djalë” asociohen me fushën leksikore të ngjyrave (rozë, blu, e purpurt etj.), të subjektit të përrallave (me princesha, zana, magjistrica, prinër etj) ose fabulave (kryesisht të rrëfenjat “për djem”), të kufizimit dhe orientimit specifik të spektrit të personazheve në secilin prej botimeve etj.

Cilësimet gjuhësore janë shumë të rëndësishme në qasjet që kanë fëmijët ndaj një produkti të krijuar për ta (qoftë lojë, libër, muzikë etj) dhe ata orientohen përmes këtyre stereotipave gjinorë që në moshë të vogël. Për vëzhguesit e rastësishëm, kodimi gjinor i informacioneve që iu japim fëmijëve nuk është i ndonjë rëndësie të veçantë, por në të vërtetë është duke u modeluar një vizion i gatshëm i asaj që fëmijët duhet të jenë, apo pëlqejnë dhe kjo përbën një çështje delikate.

Morëm shkas për një vëzhgim të tillë nga një sërë botimesh për fëmijë që qarkullojnë në libraritë në Shqipëri. Disa prej tyre i kemi pasyruar edhe me foto, pa u ndalur te shtrirja e diskutimit të entet botuese apo më gjerë. Qëllimi i vëzhgimit tonë ishte me karakter sociolinguistik, prandaj qasja që bëmë nuk mund të ndalej vetëm në përdorimin e gjuhës, por edhe te impakti që ka kjo lloj përzgjedhjeje mbi publikun e vogël që i drejtohet. Edhe vajzave iu pëlqejnë fabulat, historitë me kafshëza të vogla, bëmat e heronjve, mjetet e transportit apo lojërat logjike (LEGO) që ishin ekskluzivisht në sektorin “blu” (të djemve).

Po kështu, historitë me princër, magjistare e dragonj janë tërheqëse edhe për djemtë dhe në këtë mënyrë gjendemi në një vorbull të pakëndshme seleksionimi. Duhet t’i lëmë fëmijët të zgjedhin përrallat dhe rrëfenjat e preferuara, jo të bëjmë përmbledhje dogmatike në vëllime “blu” apo “rozë”, sikurse te pasqyra e rrëfenjave për vajza që kemi veçuar më poshtë me foto.





Objekt i punimit tonë ka qenë studimi i paradigmave ligjërimore, në një prej variabileve sociolinguistike, pikërisht ajo që prek identitetin gjinor, por duke i parë tiparet e tyre në qasje me ligjërimin e të rinjve. Gjatë anketimit që vëzhguam më sipër, ne kemi arritur të nxjerrim disa tipare interesante të ligjërimin të femrave, përkundrajt atyre të meshkujve. Natyrisht që një krahasim i tillë është burim për një studim më të thelluar, por ne do të listojmë një grup tiparësh që ilustron më së miri studimin tonë:

1. Ligjërimi i femrave është ligjërim i kujdesshëm, ka qëndrim subjektiv dhe shprehës, i karakterizuar nga luhajtje emocionale. Elementet paralinguistike që e shoqërojnë janë hezitimi, shpejtësia e të folurit dhe prania e skemave intonacionore të larmishme. (Argumenti bazë i anketës ishte përshkrimi i një ngjarjeje nga jeta e përditshme).
2. Tipet e argumenteve të zgjedhura për bashkëbisedim janë specifike dhe lidhen me sferën afektive, atë familjare, shoqërore ose edhe tendencë e art.
3. Përdorim i kujdesshëm i gjuhës dhe shmangie nga zhargoni vulgar. Më tepër vërehen disa formula fatike dhe sinjale bisedore që tregojnë hezitim, pasiguri dhe tërheqje nga konversacioni negativ.
4. Sa i takon orientimit drejt standardit, mund të themi që vërejmë një prirje të përgjithshme të respektimit të normave nga femrat, sidomos në moshat e reja, megjithëse në situatat joformale konturohen profile dialektofone hibride. Gjatë hulumtimit të anketimeve vëreheshin dy prirje kryesore: nga njëra anë përdorimi i formave standard konturon prestigjin gjuhësor si element i pushtetit gjuhësor, si i tillë, përzgjedhja e këtij varieteti krijon një bazë të sigurt në integrimin shoqëror. Nga ana tjetër, natyrshmëria e shprehjes në të folmet origjinare, duket sikur nuk i markon përdorueset në situata joformale, përkundrazi, ato me vetëdije zgjedhin format vernakulare përkundrajt atyre normative (theksojmë këtu tiparet fonetike dhe pjesërisht morfologjike të dialektit geg, që karakterizonin subjektet tona.)
5. Krijimi i stereotipave socialë përmes dallimit gjinor, në pikëpamje gjuhësore, lidhet së pari me kompetencën leksikore, përzgjedhjen e një leksiku disi të fshehtë në lidhje me sferën intime, apo ato miqësore/dashurore.
6. Prirje konverguese në bashkëbisedim, duke shfaqur forma tipike të solidaritetit gjuhësor, sidomos në peer-group-et.

Jemi të vetëdijshme se kur flasim për tipare gjinore të gjuhës, do të duhet t'u referoheshim përveç zgjedhjeve gramatikore e leksikore të fjalëve që ekzistojnë, edhe asimetrive semantike të bazuara në stereotipe. Asimetritë semantike duket se derivojnë nga përdorimi i gjuhës. Ato kanë të bëjnë me përdorimet e veçanta gjuhësore nga femrat, si në përdorimin e mbiemrave cilësorë, diminutivët, zbulimet etj. Konturimi i imazheve përmes figuracionit (metaforës, metonimisë, eufemizmave si dhe stilemeve stereotipike), si dhe teknikat ligjërimore, përdorimi i tonit, volumit të zërit etj. (shembuj mbiemrash: e padjallëzuar, altruiste, e brishtë, hysterike, diminutivë, psh.: *mamina*, *mamaka*, *yll*, *gruazë* etj);

Si përfundim mund të themi se konstruktet gjinore përgjithësisht ndërveprojnë me faktorë të tjerë shoqërorë, siç janë: statusi, klasa, roli i interlokutorit dhe tipi i situatës së komunikimit. Gjuhën nuk duhet ta konsiderojmë thjesht si një mjet komunikimi e informimi, por si një prej

sistemeve simbolike më të rëndësishme që kemi në dispozicion. Ky konceptim sociolinguistik që i bëme gjuhës, si një prodhim i drejtpërdrejtë i shoqërisë që e përdor, duket sikur priret ta modifikojë disi gjuhën, në përshatje me integrimin gjinor.

Është e qartë se kalimi nga format e zakonshme të përdorimit të stereotipeve gjinore, në format e duhura në bazë të kontekstit nuk është shumë i lehtë. Do kishte shumë prej nesh që do të pohonin me zë ose nën zë, që kemi gjëra më të rëndësishme për të diskutuar, çështje më të zjarrta ku duhet t'i orientojmë energjitë e diskutimet, sesa të tilla përcaktime, megjithatë jemi të mendimit se çdo formë e veçantë e konturimit të identitetit të të gjitha qelizave të organizmit shoqëror dhe mënyrës se si ato e përdorin gjuhën, do të krijonte një imazh të konsoliduar të të gjithë bashkësisë dhe krijimit të një statusi të denjë për të gjithë përdoruesit/et e gjuhës.

Në lidhje me ideologjitë gjinore, antropologjia gjuhësore e ka cilësuar gjuhën si mjetin më të fuqishëm të shprehjes. Forca e shprehjes së mendimit gjuhësor ndikon në identitetin social të folësve. Si një konstrukt shoqëror, atë mund ta përdorim për të përqaftuar, përjashtuar, abuzuar, kërcënuar, inkurajuar dhe dashuruar. Përfshirja e vetëdijshme ose jo në rolet shoqërore, na bën pjesë të modeleve ligjërimore të pritshme, prandaj duhet të kuptojmë që gjuha na shfaqet si një nga mjetet kryesore të seksizimit, por edhe mjeti parësor për ta luftuar atë. Përmes këtij parashtrimi, u përpoqëm të krijojmë një ide të përgjithshme mbi mënyrën sesi ndikojnë konstruktet sociale në paradigmat ligjërimore që përcaktojnë identitetet gjinore, por jemi të vetëdijshme se mbetet ende shumë për t'u bërë në lidhje me përcaktimin e një fizionomie edhe më të qartë të tipave të asimetrive që prekin këto paradigma në domene të ndryshme sociolinguistike.

Referencat

- [1]. Burke, P., (1990) *Lingua, societa' e storia*, Laterza.
- [2]. Calder, J. (2020) *Language, gender and sexuality: interrogating normativities in the field*. Gender and Language, 14(4), 429-454.
- [3]. Cameron, D., (2024) *Language, Sexism and Misogyny*, Routledge, New York.
- [4]. Cardinaletti, A., Giusti, G., (1991) *Il sessismo nella lingua italiana. Riflessioni sui lavori*, in "Rassegna Italiana di Linguistica Applicata", n.2.
- [5]. Çabej, E., (1978) *Linguistics' studies* (IV), Prishtinë.
- [6]. Dardano, M., (2008) *Costruire parole*, Il Mulino.
- [7]. Eckert, P., McConnell. S., (2013) *Language and gender*, (2nd Edition), Cambridge University Press.
- [8]. Edwards, J., (2009) *Language and Identity, an introduction*, Cambridge University Press.
- [9]. Ehrlich, S., (2019) "Well, I Saw the Picture: Semiotic Ideologies and the Unsettling of Normative Conceptions of Female Sexuality in the Steubenville Rape Trial." Gender and Language 13 (3): 251–269.
- [10]. Hudson, A. R., (2002) *Sociolinguistika*, Tiranë.
- [11]. Hysa, E., (2004) *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
- [12]. Lakoff, R., (1973) "Language and woman's place", Language in Society 2(1).
- [13]. Lazar, M. (ed.) (2005) *Feminist critical discourse analysis: gender, power and ideology in discourse*, Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- [14]. Lepschy, G., (1988) *Lingua e sessismo*, in "L'Italia dialettale", n.7.
- [15]. Luraghi, S., Olita, A., (2006) *Linguaggio e genere*, Carocci, Roma.
- [16]. Manne, K., (2018) *Down girl: the logic of misogyny*, Oxford University Press.
- [17]. Marcato, G., (1995) *Donna e linguaggio*, Padova.
- [18]. Mills, S., (2008) *Language and sexism*, Cambridge University Press.
- [19]. Robustelli, C., (2000) *Lingua e identità di genere. Problemi attuali nell'italiano*, in "Studi Italiani di Linguistica Teorica e Applicata", 3/29.
- [20]. Pauwels, A., (1998) *Women changing language*, London: Longman.
- [21]. Pinker, S., (2007) *The Language Instinct: How the Mind Creates Language*, New York: Harper Perennial Modern Classics.
- [22]. Sabatini, A., (1986) *Raccomandazioni per un uso non sessista della lingua italiana*, Roma, Presidenza del consiglio dei ministri.
- [23]. Tollefson, J., (1981) *The role of language planning in second language acquisition*.
- [24]. Trudgill, P., (2001) *Sociolinguistics: An Introduction to Language and Society*, Fourth Edition Paperback.
- [25]. Violi, P., (1986) *L'infinito singolare*.